



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0138

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) ARMAKOS SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi me laura dhe pjesë të tyre në ndërtesat qeveritare me numër të prokurimit 214-25-7284-1-1-1, me 15/04/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjeserisht e bazuar ankesa e OE ARMAKOS SH.P.K. me nr. 2026/0138 , e datës 06/03/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi me laura dhe pjesë të tyre në ndërtesat qeveritare me numër të prokurimit 214-25-7284-1-1-1.
2. Anullohet në tërësi aktiviteti i prokurimit Furnizimi me laura dhe pjesë të tyre në ndërtesat qeveritare me numër të prokurimit 214-25-7284-1-1-1
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik ARMAKOS SH.P.K.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 08.08.2025. MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me laura dhe pjese te tyre ne ndertesat qeveritare" me nr. të prokurimit: "214-25-7284-1-1-1

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: furnizim, vlera e parashikuar e kontrates: **150,000.00€**.

Me 25.02.2026 MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë OE Kotech.

Me 29.02.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 05.03.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 06.03.2026 ARMAKOS SH.P.K, ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0138, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhenie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues ARMAKOS SH.P.K, janë parashtruar si në vijim: Kjo ankesë parashtrohet kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues (MPB): Për eliminimin e OE ARMAKOS Sh.p.k. mbi bazë të pretenduar të pavlefshmërisë së sigurimit të tenderit; Për shpalljen fitues të OE KOTECH SH.P.K., i cili ka paraqitur produkt të markës JOVISION pa autorizim të prodhuesit. Vendimi i AK është në kundërshtim me: Nenin 7 të LPP (parimet themelore); Nenin 57 të LPP (sigurimi i tenderit); Nenin 59 të LPP (vlerësimi i tenderëve); Nenin 65 të LPP (kualifikimi); Praktikën e konsoliduar të OSHP lidhur me proporcionalitetin dhe deklaratimet e rreme.

LIDHUR ME SIGURIMIN E TENDERIT Interpretim i gabuar i Nenit 57 LPP Neni 57 kërkon që sigurimi i tenderit të jetë i vlefshëm për periudhën e vlefshmërisë së ofertës. Oferta jonë ishte 90 ditë valide. Sigurimi ynë ka mbuluar këtë periudhë. Praktika e vazhdueshme e OSHP ka theksuar se sigurimi duhet të mbulojë periudhën reale të ofertës dhe jo një periudhë teorike të papërdorur nga AK. Në disa vendime të mëhershme, OSHP ka theksuar: Nëse oferta është 90 ditë valide dhe sigurimi mbulon 90 ditë, nuk ka rrezik real për AK. Po ashtu, AK në dosjen e tenderit (FDT), në rubrikën e validitetit të sigurisë, ka dhënë dy afate të vlefshmërisë së sigurisë së tenderit: tek rreshti i shumës ka shënuar shumën e sigurisë dhe validitetin e sigurisë prej 120 ditë, ndërsa tek rreshti i afatit të validitetit ka shënuar periudhën kohore të validitetit të sigurisë së tenderit prej 90 ditë. Kur kemi kërkuar nga kompania e sigurimeve garancionin, ata na kanë dërguar garancionin prej 90 ditë duke na siguruar se, meqenëse në FDT Neni 22.1 thuhet qartë: “Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 90 ditë”, dhe ka dy afate të vlefshmërisë së sigurimit, afati prej 120 ditë mund të jetë ndonjë gabim teknik gjatë mbushjes së dosjes. Në favor të këtij opinioni shkon edhe kërkesa e AK për zgjatje të sigurimit dhe validitetit të tenderit pas 90 ditëve të skadimit dhe jo pas 120 ditëve, si dhe fakti që afati i zgjatjes është 90 ditë për garancion të sigurisë dhe 90 ditë për validitet të ofertës. Eliminimin në këtë rast e konsiderojmë disproporcional, që sjell në veprim Nenin 7 të LPP – Parimin e proporcionalitetit.

Parimi i proporcionalitetit – Neni 7 LPPOSHP në praktikën e saj ka theksuar se eliminimi për mospërputhje formale që nuk ndikojnë në substancë përbën shkelje të proporcionalitetit. Në rastin konkret: AK, duke ofruar dy periudha të ndryshme kohore të validitetit, ka devijuar nga formulari standard dhe ka krijuar paqartësi sistematike. Meqenëse afati i vlefshmërisë së tenderit në FDT, Neni 22.1, thuhet qartë: “Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 90 ditë”, garancioni prej 90 ditë nuk ka përbërë rrezik financiar për AK. Nuk ka pasur mashtrim. Nuk ka pasur mungesë sigurimi. Prandaj eliminimi është formalizëm ekstrem. PJESA E DYTË E ANKESËS – ÇËSHTJA THELBËSORE AK KA SHPALLUR FITUES NJË OE TË PA PËRGJEGJSHËM

Në FDT të dosjes së tenderit – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 9.1 & 9.2, kapaciteti teknik dhe profesional pika 3, AK ka kërkuar autorizim nga prodhuesi apo distributori (MAF apo DAF) me të dhënat për këtë aktivitet të prokurimit, si titulli i aktivitetit dhe numri i prokurimit.

AK, duke ditur se përmbajtja e kërkesave të produkteve të ndryshme të dosjes së tenderit është e pamundur të merren nga një prodhues, nuk ka specifikuar se për çfarë produkti duhet autorizimi dhe për çfarë produkti nuk duhet, me çka ka lënë hapësirë për interpretime të ndryshme.

Në formularin e specifikacionit teknik, si specifika teknike të detyrueshme për pikën A2, është kërkuar LPR kamerë. OE i shpallur fitues nga AK, KOTECH, ka ofruar në katalogun A1-A15 (faqet 24 & 25 të katalogut të tyre) një datasheet të LPR kamerës JVS-N819-LPR – Jovision Technology Co., Ltd., pa leje dhe autorizim të prodhuesit. Në fund të datasheet shihet qartë: “Shënim: Dizajni dhe specifikimet mund të ndryshojnë pa paralajmërim. Në asnjë rrethanë, ky dokument nuk duhet të riprodhohet, shpërndahet ose ndryshohet pjesërisht ose tërësisht pa autorizimin formal të Jovision Technology Co., Ltd.” Duke pasur parasysh faktin se Jovision Technology Co., Ltd. është partner i yni në biznes dhe vetëm ARMAKOS L.L.C. ka qenë i autorizuar për këtë tender nga ana e tyre, kjo e bën edhe më të qartë lëshimin e AK që nuk ka bërë vlerësimin e duhur dhe eliminimin e KOTECH për keqpërdorim dhe deklaram të rremë.

Fakti se OE KOTECH ka përdorur një datasheet ku prodhuesi e ndalon përdorimin e tij pa autorizim dhe prodhuesi, si partner i yti, ka autorizuar kompaninë tonë për këtë tender, rrëzon pretendimin e AK se ata nuk kanë kërkuar autorizim të veçantë për kamerë LPR.

Përmbledhje Në katalogun e ofertës së OE KOTECH është paraqitur datasheet i JVS-N819-LPR i prodhuesit Jovision Technology Co., Ltd. Por: Nuk ka paraqitur Manufacturer Authorization. Nuk ka paraqitur dëshmi të distributor-it zyrtar. Nuk ka paraqitur marrëdhënie kontraktuale me prodhuesin, dhe pa këto mbulesa përdorimi i këtij datasheet është i ndaluar rreptësisht nga prodhuesi.

ARMAKOS KA AUTORIZIM EKSKLUZIV ARMAKOS në dosjen e ofertës ka paraqitur autorizim nga prodhuesi JOVISION për këtë tender.

Ky fakt krijon situatë juridike të qartë: Vetëm një OE ka të drejtë reale furnizimi. PRAKTIKA E OSHP PËR DEKLARIME TË RREMENË vendime të mëhershme, OSHP ka theksuar: Paraqitja e produktit pa autorizim përbën paraqitje të pasaktë. Nëse OE nuk dëshmon lidhjen me prodhuesin, oferta është e papërgjegjshme. AK ka detyrim të verifikojë autenticitetin e ofertës. OSHP ka theksuar gjithashtu: Kur ekziston dyshim serioz për aftësinë reale të furnizimit, AK duhet të diskualifikojë OE.

SHKELJE E NENIT 59 LPPAK ka detyrim të:Ekzaminojë në detaje ofertat;Verifikojë përputhshmërinë teknike;Sigurojë që oferta është reale dhe e zbatueshme.Mosverifikimi i autorizimit për përdorimin e datasheet të produktit, në të cilin prodhuesi ka bërë shënim të qartë se çdo përdorim i tij pa autorizim është i ndaluar, është dështim në vlerësim.

SHKELJE E BARAZISËSituata aktuale:OE i autorizuar eliminohet;OE i paautorizuar shpallet fitues.Kjo përbën:Shkelje të nenit 7;Cenim të konkurrencës së ndershme;Trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë.

RREZIK PËR INTERESIN PUBLIKNë mungesë autorizimi:Nuk garantohet furnizimi.Nuk garantohet garancia e prodhuesit.Nuk garantohet origjinaliteti.OSHP në praktikën e saj ka theksuar se interesi publik prevalon mbi formalizmin procedural.

KONKLUZIONI JURIDIKVendimi i AK është:Proceduralisht i gabuar (sigurimi);Materialisht i paligjshëm (mungesa e autorizimit);Në kundërshtim me praktikën e OSHP;Në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtimDetale dhe argumente për pretendimet e neneve të shkelura dhe pikat ankimore për rishqyrtim të lartcekura nga OE, Autoriteti Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme, konstaton se ka vepruar në harmoni të plotë me LPP-në dhe nenet: Neni 1 Qëllimi; Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti; Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo diskriminim. Ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë OE ofertuese, në harmoni të plotë me Nenin 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, Nenin 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe Nenin 40 të Rregullores A01 Rregullore Nr.002/2024 për Prokurimin Publik – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, si dhe në harmoni me LPP-në Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës, dhe kriteret e vendosura në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit duke trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE-të. Kriteri për dhënie të kontratës është oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë dhe mbi këtë bazë AK-MPB ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë OE-të në këtë AP.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 1Tenderuesi ankues Armakos shpk pretendon se AK ka eliminuar ofertën e tij me arsyetimin se sigurimi i tenderit me rastin e dorëzimit të ofertave ka qenë në rregull dhe duhet pranuar.

ZPP, pas shqyrtimit të këtij pretendimi dhe analizimit të komplet procedurës dhe dokumentacionit të ofertës në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, ka vërejtur se me dosjen e tenderit, përveç tjerash, është kërkuar që OE të dorëzojë sigurimin e tenderit në vlefshmëri prej 120 ditë nga data e fundit për dorëzim të tenderëve, ndërsa sigurimi i tenderit i bashkangjitur në ofertë është në afat të vlefshmërisë prej 90 ditëve. Bazuar në paragrafin 28.6 të nenit 28 të Rregullores së Prokurimit Publik: “Sigurimi i tenderit do të qëndrojë valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit”, në rastin konkret, përveç që nuk është dorëzuar sigurimi i tenderit në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit, i njëjti është edhe në kundërshtim me nenin 28 të RRUPP.

Si rrjedhojë e kësaj, Komisioni i Vlerësimit me të drejtë ka vendosur në eliminimin e ofertës tuaj dhe ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 2Tenderuesi ankues Armakos shpk pretendon se AK ka përzgjedhur OE i cili është i pa përgjegjshëm për arsye se i njëjti nuk ka dorëzuar autorizim nga

prodhuesi për një pozicion të kamerave.ZPP, pas analizimit në tërësi të dokumentacionit të aktivitetit, dosjes së tenderit, ofertave dhe pretendimit të OE ankues, konstaton dhe sqaron se në Dosjen e Tenderit është kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin autorizim nga prodhuesi apo distributori (MAF/DAF), në të cilin duhet të përfshihen të dhënat e aktivitetit të prokurimit, si: titulli i aktivitetit dhe numri i prokurimit. Kjo kërkesë është vendosur me qëllim të sigurimit që operatorët ekonomikë janë të autorizuar për furnizimin me mallrat që përbëjnë objektin kryesor të këtij aktiviteti të prokurimit, respektivisht furnizimin me laura dhe pjesë të tyre.

Në Dosjen e Tenderit nuk është kërkuar autorizim i veçantë apo specifik për secilin artikull individual të përfshirë në listën e specifikimeve teknike. Për rrjedhojë, nuk është kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin autorizim të veçantë për artikullin “kamera”.

Objekti i këtij aktiviteti të prokurimit është furnizimi me laura dhe pjesë të tyre, ndërsa artikujt e tjerë të përfshirë në listë, përfshirë edhe kamerat, paraqesin komponente ose pajisje plotësuese që lidhen me funksionalitetin e sistemit në tërësi dhe nuk përbëjnë objekt të veçantë të prokurimit për të cilin kërkohet autorizim i veçantë. Andaj, në këtë pikë, ZPP konstaton se pretendimi është i pabazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 11.03.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0138, ndërsa me datë 24.03.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0138, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhenje të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e ARMAKOS SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0138 ka vlerësuar si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Pretendimi nr. 1 Pretendimi i parë ankimor sipas ankesës 138/26 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk e ka ofruar sigurimin e tenderit për 120 ditë, ashtu si është kërkuar në dosje, por ka ofruar sigurimin vetëm për 90 ditë.

OE ankues pretendon se:“Në rastin konkret:AK duke ofruar dy periudha të ndryshme kohore të validitetit ka devijuar nga formulari standard dhe ka krijuar paqartësi sistematike,

Meqenëse afati i vlefshmërisë së tenderit në FDT, Neni 22.1, thuhet qartë: “Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 90 ditë”, garancia prej 90 ditësh nuk ka përbërë rrezik financiar për AK.Nuk ka pasur mashtrim.Nuk ka pasur mungesë sigurimi.Prandaj eliminimi është formalizëm ekstrem”.Pas analizimit të dosjes së tenderit, ashtu siç pretendon OE ankues, kemi gjetur se kërkesa në dosje është si në vijim:

13.2Shuma e Sigurimit të Tenderit duhet të jetë 3,000.00 euro, me vlefshëmri prej 120 ditë.për periudhë valide prej [shëno kohëzgjatjen në ditë 90 apo muaj]Ashtu siç pretendon OE ankues, AK në dosje të tenderit ka përcaktuar dy periudha kohore të sigurimit (120 ditë dhe 90 ditë).

Me qenë se dispozitat e LPP në fuqi nuk e trajtojnë problematikën e kërkesave të paqarta, atëherë mendojmë se duhet të nxjerrim analogji juridike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku dispozitat e paqarta të shkruara/formuluara nga njëra palë do të interpretohen në dobi të palës tjetër, që në rastin konkret i bie të interpretohet në dobi të OE ankues, pasi është AK pala e cila ka përpiluar dispozitën/kërkesën e paqartë në dosje të tenderit.Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi nr. 2 OE ankues pretendon se“OE i shpallur fitues nga AK për këtë tender KOTECH ka ofruar në katalogun A1-A15 (faqet 24 & 25 të katalogut të tyre) një datasheet të LPR kamerës JVS-N819-LPR – Jovision Technology Co., Ltd., pa leje dhe autorizim të prodhuesit.

Në fund të datasheet shihet qartë: Shënim: Dizajni dhe specifikimet mund të ndryshojnë pa paralajmërim.Në asnjë rrethanë, ky dokument nuk duhet të riprodhohet, shpërndahet ose ndryshohet pjesërisht ose tërësisht pa autorizimin formal të Jovision Technology Co., Ltd.

Duke pasur parasysh faktin se Jovision Technology Co., Ltd. është partner i yni në biznes dhe vetëm ARMAKOS LLC ka qenë i autorizuar për këtë tender nga ana e tyre, kjo e bën edhe më të qartë lëshimin e AK që nuk ka bërë vlerësimin e duhur dhe eliminimin e KOTECH për keqpërdorim dhe deklaram të rremë.

Fakti se OE KOTECH ka përdorur një datasheet ku prodhuesi e ndalon përdorimin e tij pa autorizimin e tij dhe prodhuesi si partner i yni ka autorizuar kompaninë tonë për këtë tender, rrëzon pretendimin e AK se ata nuk kanë kërkuar autorizim të veçantë për kamerë LPR.

Përmbledhje:Në katalogun e ofertës së OE KOTECH është paraqitur: datasheet i JVS-N819-LPR i prodhuesit Jovision Technology Co., Ltd.

Por:Nuk ka paraqitur Manufacturer Authorization.Nuk ka paraqitur dëshmi të distributorit zyrtar.Nuk ka paraqitur marrëdhënie kontraktuale me prodhuesin dhe pa këto mbulesa përdorimi i këtij datasheet është i ndaluar rreptësisht nga prodhuesi.

ARMAKOS KA AUTORIZIM EKSKLUZIV.

ARMAKOS në dosjen e ofertës ka paraqitur autorizim nga prodhuesi JOVISION për këtë tender. Ky fakt krijon situatë juridike të qartë:Vetëm një OE ka të drejtë reale furnizimi.”.Pas analizimit të ofertës të OE të rekomanduar për kontratë, nga autorizimet e prodhuesve të ndryshëm që ka

ofruar OE, nuk kemi gjetur autorizim nga prodhuesi Jovision për produktin “JVS-N819-LPR”. Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimi ankimor është i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi me lura dhe pjese te tyre ne ndertesat qeveritare” me nr. të prokurimit: "214-25-7284-1-1-1

Në kete procedurë të prokurimit Paneli Shqyrtues ka konstatuar se në rastin konkret nuk është kontestuese se OE ankues dhe as OE i rekomanduar kane dorëzuar ofertë të përgjegjshme. Në këtë kontekst, PSH konstaton se ankesa duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar, megjithatë, PSH nuk ka gjetur mbështetje ligjore për ta kthyer vendimin e AK lidhur me kete aktivitet te prokurimit në rivlerësim dhe po ashtu nuk ka gjetur mbeshtetje ligjore qe te vendos qe Vendimi i Autoritetit Kontraktues të mbetet në fuqi.

Lidhur me pretendimin e parë të parashtruar nga OE ankues në këtë ankesë, i cili ka të bëjë me arsyen e eliminimit të tij, sipas të cilës AK-ja ka konstatuar se OE ankues nuk ka ofruar sigurimin e tenderit për periudhën prej 120 ditësh, ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit, por vetëm për 90 ditë, Paneli Shqyrtues vlerëson se nga analiza e FDT konstatohet se në këtë rast është bërë një gabim teknik nga ana e Autoritetit Kontraktues, i cili konsiderohet i pa përmirësueshëm, pasi nga ana e AK-së janë përcaktuar dy standarde të ndryshme lidhur me periudhën e vlefshmërisë së sigurimit të tenderit. Konkretisht, është kërkuar që shuma e sigurimit të tenderit të jetë 3,000.00 euro me vlefshmëri prej 120 ditësh, ndërsa njëkohësisht është përshkruar edhe një periudhë valide prej 90 ditësh (apo muaj, sipas formulimit të paqartë në dokument).

PSH vlerëson se kjo mospërputhje përbën një pasaktësi thelbësore në dokumentet e tenderit, e cila cenon parimet e barazisë dhe transparencës në procedurën e prokurimit dhe nuk mund të korrigjohet.

Në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 62 të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues është dashur të anulojë këtë aktivitet të prokurimit, për shkak se ka ndodhur një shkelje e ligjit në procedurë, e cila nuk mund të rregullohet. Sipas kësaj dispozite, Autoriteti Kontraktues duhet të përfundojë aktivitetin e prokurimit pa dhënie kontrate në rastet kur konstatohet një shkelje e tillë e pariparueshme.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nën punëseve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund

të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - ARMAKOS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: